



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 71, Datë 10.03.2026

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “SUNNY SIDE ENERGY” SH.P.K. PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET BARRËSIMIT) TË ASETEVE FIKSE TË SAJ SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA” SH.A.

Në mbështetje të neneve 16, 20, gërma “a”, dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, gërmat “a” dhe “b”, 7 dhe 8 të *Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.07.2016; si dhe neneve 15 dhe 19 pika 1, gërma “a”, të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe pikave 1.3 dhe 1.6 të *“Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”* miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.03.2026, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 844 prot., datë 06.03.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet barrësimit) të aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a.”,

Konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë “Sunny Side Energy” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për Marrjen e Autorizimit

- Shoqëria “Sunny Side Energy” sh.p.k., është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 13, datë 16.01.2025, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 100 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 1451, Fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Me shkresën nr. 620 prot., datë 11.02.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a..

2. Shqyrtimi i Kërkesës dhe Dokumentacionit të Paraqitur

- Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar, ERE ka evidentuar fillimisht mosrakordim në lidhje me monedhën dhe vlerën totale të aseteve fikse të parashikuara në marrëveshjen sigurorese krahasuar me totalin e vlerës së kredisë së marrë, e nga ana tjetër dhe vlerës së parashikuar të investimit, nga kontrata e nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), datë 11.11.2024, për të cilin ka kërkuar sqarime me e-mailin e datës 24.02.2026, të protokolluar me nr. 620/1 prot., datë 24.02.2026.

- Në përgjigje, “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a. nëpërmjet e-mailit të datës 24.02.2026 dhe shkresës nr. 620/2 prot., datë 25.02.2026, ka sqaruar se në marrëveshjen siguruese ishte pasqyruar gabim monedha, duke depozituar Marrëveshjen Siguruese nr. 1083 rep., nr. 458 kol., datë 24.02.2026, si amendim i marrëveshjes së mëparshme.
- Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës në mbledhjen e bordit të ERE-s në datë 26.02.2026 përgatiti “Informacion mbi kërkesën e shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k., të protokolluar me nr. 620/3 prot., datë 25.02.2026, në lidhje me këtë aplikim/procedurë, me anë të së cilës sqaroi se me depozitimin/saktësimin e dokumentacionit të kërkuar, lind nevoja e shqyrtimit përkatës, ndaj afati procedural i këtij aplikimi do të konsiderohet data 24.02.2026, kjo në mënyrë që ERE të vijojë me analizimin e dokumentacionit të depozituar në lidhje me këtë aplikim.

3. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe të neneve 2, gërma “a”, 3, 4 dhe 6 të *Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016, rezulton se ERE miraton kërkesat e të licensuarave për transferimin e aseteve fikse të saj që i shërbejnë veprimtarisë së licensuar.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në mbështetje të përcaktimeve të nenit 7 të “*Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit*”, rezulton se nevojitet të plotësohet dhe qartësohet më tej dokumentacioni/informacioni si vijon:

4. Plotësimi i Kërkesës sipas nenit 7, pika 1:

- **Gërma “c”** – Shoqëria duhet të bëjë me dije në mënyrë më të detajuar lidhur me gjendjen financiare të saj dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve, në kushtet kur kredia e marrë do të shërbejë, ndër të tjera, edhe për rikthimin e pjesshëm të fondeve të dhëna nga ortaku dhe brenda grupit të shoqërive;
- **Gërma “d”**- Shoqëria duhet të depozitojë sqarime në lidhje me rolin e ortakut të vetëm të saj, në cilësinë e bashkëkredimarrësit, sipas Kontratës së Kredisë Bankare nr. 7775 rep., nr. 2810 kol., datë 26.12.2025.;
- **Gërma “e”** Shoqëria duhet të informojë më tej në lidhje me arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit, konkretisht përse vendosja e barrës siguruese mbi asetet e shoqërisë së licensuar kërkohej për garantimin e një marrëdhënie kredie ku përfshihet edhe ortaku i saj i vetëm në cilësinë e bashkëkredimarrësit.
- **Gërma “f”** Shoqëria duhet të informojë në mënyrë më të plotë në lidhje me efektet e pritshme të transferimit mbi aktivitetin e licensuar, në veçanti në raport me strukturën e financimit të projektit dhe detyrimet që lidhen me ortakun/bashkëkredimarrësin.
- **Gërma “h”** Shoqëria duhet të saktësojë dhe dokumentojë më tej rrethanat e Kontratës së Kredisë Bankare nr. 7775 rep., nr. 2810 kol., datë 26.12.2025, dhe të Marrëveshjes Siguruese nr. 1083 rep., nr. 458 kol., datë 24.02.2026, lidhur me natyrën e detyrimit të garantuar, rolin e secilës palë në këtë marrëdhënie dhe destinacionin e saktë të fondeve të përfituara nga kredia.
- **Gërma “i”** Shoqëria duhet të paraqesë në ERE sqarime të mëtejshme nga banka financuese në lidhje me marrëdhënien e saj kontraktore me kredimarrësin dhe bashkëkredimarrësin, si dhe me objektin e saktë të garantimit që kërkohej të mbulohej nëpërmjet barrësimit të aseteve të shoqërisë së licensuar.
- **Pika 3** Shoqëria duhet të sqarojë nëse Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është informuar për këtë kërkesë, si dhe të depozitojë dokumentacionin përkatës të komunikimit, nëse ka.

- Për sa më sipër, vlerësohet se ndodhemi në kushtet e fillimit të procedurës për shqyrtimin e kërkesës, me qëllim administrimin e sqarimeve të mëtejshme në lidhje me rrethanat e marrëveshjes së financimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet barrësimit) të aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a., lidhur me Kontratën e Kredisë Bankare nr. 7775 rep., nr. 2810 kol., datë 26.12.2025, dhe Marrëveshjen Siguruese nr. 1083 rep., nr. 458 kol., datë 24.02.2026.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “Sunny Side Energy” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI